3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit
Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [**Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in**]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: [*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne [*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*].

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[**Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit**]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i OfertuesNënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE “BLERJE MOBILJE PËR ZYRAT”

1) Kolltuku tek.

Kolltuku tek duhet te kete permasa 66x68x83cm. kolltuku duhet te jete ne forme gjysem te rumbullaket me permasa 66x68x63cm dhe duhet te jete i mbeshetur ne nje bazament metalik me 4 (kater) kembe te rumbullakta qe qendrojne 3-5cm. ne pjesen e jashtme te karriges kembet ne fund duhet te kene tapa plastike per te minimizuar zhurmat dhe per te eleminuar gervishtjet.

2) Karrige lekure e levizshme me rrota.

Karrigia duhet te jete e rrotullueshme, e mbeshetur ne nje bosht metalik me 5 (pese) cepa dhe ne skajet e tyre te jene te pajisura me rrota plastike cilesore peshe mbajtese, me diameter 60cm.

Lartesia e karriges duhet te jete 113x121cm

Ndenjesja duhet te jete me permasa 48x50cm

Shpinorja duhet te jete me permasa 48x78cm

Karrigia duhet te kete funksion ulje dhe ndritje qe realizohet me nje mekanizem i cili ndodhet ne krahun e djathte, ndersa ne krahun e majte ndodhet nje mekanizem tjetër qe ben te mundur pozicionimin e karriges ne 3 (tre) pozicione para dhe pas.

Karrigia duhet te jete e veshur me lekure ekologjike te cilesise se pare antibakteriale.

Ndenjesja dhe mbeshtetesja duhet te kene punime dekorative.

Rregullimi i larteseise realizohet nepermjet nje pistonit.

3) Karrige rrotulluese me stof

Karrigia duhet te jete rrotulluese, ngjyre zeze. Lartesia e karriges nga toka duhet te jete 120-130cm. Lartesia nga ndenjesia duhet te jete 48 cm. Ndenjesia duhet te jete me dimensione 50x50cm material cope, me trashesi 6cm. Pjesa shpinore duhet te jete rrjete, me dimensione 60x43cm. Pjesa e pasme e fundshpinores duhet te jete plastike me dimensione 37x10cm per nje qendrim sa me komod. Krahet duhet te jene plastike me permasa 25x10cm drejtekendore me lartesi nga ndenjesia 10cm ne pozicionin e mbyllur dhe 20cm ne pozicionin e hapur. Krahu i karriges duhet te kete levije lart dhe posht si dhe para dhe pas per tu pershtatur sa me mire me perdoruesin. Ne pjesen e poshtme te ndenjeses ka nje mekanizem qe sherben per levizjen e ndenjeses ne pozicion para dhe pas qe sherben per t'u pershtatur sa me mire me perdoruesin. Opsioni i uljes dhe ngritjes duhet te realizohet nga nje piston qe komandohet nga nje mekanizen i cili ndodhet ne krahun e djathte. Ne krahun e majte te karriges ndodhet nje mekanizem qe realizon opsionin e karriges para dhe pas. Bazamenti i rrotave duhet te jete 66cm.

4) Tavoline e vogel mesi 120x60x40cm

Tavolina e vogel e mesi duhet te jete me te njejtin material si tavolina e punes se titullarit, melamin me permasa 120x60x40cm. Trashesia e syprines duhet te jete 8 – 10cm dhe trashesia e kembeve duhet te jete e njejte me syprinen, e cila duhet te jete e lyer me boje (caktohet nga Autoriteti Kontraktor). Ne fund te kembeve duhet te kete tapa fundore ne menyre qe te minimizoje zhurmat dhe gervishtjet.

5) Tavoline pune dhe kompjuteri 140x69x75cm.

Syprina material melamine me spesor 3cm me bord 2mm.

Pjesa ballore e tavolines duhet te jete 18mm me permasa 120x35cm, me bord 2mm.

Kemba duhet te jete metalike me permasa 50x50mm dhe trashesia 2mm. Kembet jane ne forme 'U'-je dhe bashkimi i tyre realizohet me dy element metalik me permasa 140x4x4cm.

Kembet duhet te jene te lyera me boje elektrostатike me pjekje ne furre me 200°C. Ngjyra do të përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor. Kembet ne fund te tyre duhet te kete tapa plastike me mekanizem nivelimi.

Tavoline pune dhe kompjuteri per dy persona

Tavolina punes duhet te kete permasat 140x140x75cm. syprina tavolines eshte e perbere nga dy pjese simetrike 140x69cm me trashesi 3cm, krijojne nje hapsire per vendosjen e seperatorit qe ben ndarjen e postit te punes.

Seperatorit duhet te jete 140x35cm

Spesori i seperatorit duhet te jete 2cm dhe duhet te jetet i perbere nga dy shtresa mdf te veshura me cope qe eleminon zhurmat dhe ka nje distance mes te dyjave prej 2cm.

Kembet duhet te jene metalike 140x140 me spesor 50x50mm dhe trashesi 2mm.

Bashkimi i kembeve behet me ane te dy traversave prej hekuri te cilat e bejne tavolinen me solide me permasa 140x40x40cm. Ne fund te kembeve duhet te kene te vendosura tapa fundore me mekanizem nivelimi. Kembet duhet te jene te lyera me boje elektrostатike me me pjekje ne 200°C. Ngjyra do të përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor.

6) Tavoline pune dhe kompjuteri per dy persona

Tavolina punes duhet te kete permasat 140x140x75cm. syprina tavolines eshte e perbere nga dy pjese simetrike 140x69cm me trashesi 3cm, krijojne nje hapsire per vendosjen e seperatorit qe ben ndarjen e postit te punes.

Seperatorit duhet te jete 140x35cm

Spesori i seperatorit duhet te jete 2cm dhe duhet te jetet i perbere nga dy shtresa mdf te veshura me cope qe eleminon zhurmat dhe ka nje distance mes te dyjave prej 2cm.

Kembet duhet te jene metalike 140x140 me spesor 50x50mm dhe trashesi 2mm.

Bashkimi i kembeve behet me ane te dy traversave prej hekuri te cilat e bejne tavolinen me solide me permasa 140x40x40cm. Ne fund te kembeve duhet te kene te vendosura

tapa fundore me mekanizem nivelimi. Kembet duhet te jene te lyera me boje elektrostatische me me pjekje ne 200°C. Ngjyra do të përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor.

7) Tavolinë pune 250*75*90

Tavolina e punes duhet te kete syprine me trashesi 3cm dhe te jete e borduar me bord plastic 2mm. Pjesa ballore eshte me melamin 18mm dhe me permasa 150x40cm.

Kembet duhet te jene prej materiali metalik me spesor 50x50cm dhe me trashesi 2mm. Bashkimi i planit te punes duhet te behet me dy traversa me spesor 40mm dhe qe fiksohen me vida ne kembet e tavolines. Kembet ne fund te tyre duhet te kene tapa plastike me mekanizem nivelimi per te shmangur zhurmat. Kembet duhet te jene te lyera me boje elektrostatische me pjekje ne 200°C. Ngjyra do të përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor.

8) Tavoline pune 180x69x75

Tavolina e punes duhet te kete syprine me trashesi 3cm dhe te jete e borduar me bord plastic 2mm. Pjesa ballore eshte me melamin 18mm dhe me permasa 150x40cm.

Kembet duhet te jene prej materiali metalik me spesor 50x50cm dhe me trashesi 2mm. Bashkimi i planit te punes duhet te behet me dy traversa me spesor 40mm dhe qe fiksohen me vida ne kembet e tavolines. Kembet ne fund te tyre duhet te kene tapa plastike me mekanizem nivelimi per te shmangur zhurmat. Kembet duhet te jene te lyera me boje elektrostatische me pjekje ne 200°C. Ngjyra do të përzgjidhet nga Autoriteti Kontraktor.

9) Etazher zyre, duhet te kete permasa 160x40x200cm.

Etazheri duhet te kete 4 kanata te cilat duhet te jene te ndare 2 poshte, 2 lart. Gjeresia duhet te jete 160cm, thellesia 40cm, lartesia 200cm. Materiali melamin me spesor 18mm ngjyra UD. Shpinoja melamin 8mm ngjyra e njejte me kapaket. Bordi i te gjithë dollapit duhet te jete 2mm, kembe metalike 8cm.

Kanatat e poshtme 73x40cm melamin 2 cope.

Kanatat e sipërme me kornize alumini, permasa 109x40cm. Xhami transparent 4mm.

Pjesa e poshtme ka nje ndarje, pjesa e sipërme ka dy ndarje me lartesi te rregullueshme.

10) Varesë rrobash + Mbajtëse cadrash

Duhet te jete me material metalik + plastik me permasa 172 lartesi, bazamenti 45cm plastik. Duhet te kete 4(kater) vende per çadrat, 8(tete) vende per varje rrobash.

11) Kasaforte metalike

Kasaforta metalike duhet te jete me komandim elektrik dhe metalik dhe duhet te kete permasa 25x24x34cm. Trupi me trashësi 1.5 mm. Ka dy bulona me diametër 20 mm. 3 taste trekëndore me pika + tastierë. Kyçja e urgjencës. Regjistrimi i 58 hapjeve të fundit.

12) Perde vertikale

Perde vertikale shirit per zyre. Materiali i perdes duhet te plotesoje kushtet e funksionit. Copa e materialit beze e plastifikuar; Pesha e siperfaqes 200 gr/m2; menyra e vendosjes eshte e varur ne shufer metalike; Kampionet e propozuara duhet t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor per nje aprovim paraprak ne konsultim me arkitektin e Autoritetit. Skelat dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te vendosjes ne menyre perfekte jane detyrim i operatorit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit: 30 dite duke filluar nga data e lidhjes së kontratës

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 8, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”.

1. Për kapacitetin teknik i cili lidhet me aftësinë e duhur profesionale, teknike dhe organizative, personelin, burimet financiare, makineri e pajisje të tjera, reputacion dhe besueshmëri për zbatimin e kontratës, Operatori Ekonomik/bashkimi i Operatoreve Ekonomike, duhet te permbushë edhe këta kritere:

1.1 Vlerësimi i gjëndjes ekonomike dhe financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentat e mëposhtëm.

a. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit.

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2022 dhe kështu e maturuara për vitin 2022, sipas ligjit 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit).

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 20% i vlerës së përlogaritur të kontratës.

Si dëshmi e përvojës së mëparshme operatori duhet të paraqesë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një Ent Publik kërkohen vërtëtime të lëshuara nga Enti Publik dhe fatura tatimore shitje ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore. Vërtetim për realizim të suksesshëm të kontratës, lëshuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore shitje ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

2 Një punësim mesatar mujor i të paktën 7 (shtatë) punonjësve gjatë 6 mujorit të fundit, nga data e zhvillimit të kësaj procedure, të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj,
- List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislativi në fuqi për secilin muaj.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira të paktën 2 (dy) automjete për transport mallrash me kapacitet mbi një ton, për dërgimin e mallrave sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

4. Për të prezantuar aftësitë organizative, teknologjike dhe të cilësisë së produktit, Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe paraqesë:

- ISO 9001:2015 Çertifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;
- Certifikate ISO 14001-2015 Çertifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;
- ISO 45001-2018 Çertifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, secili OE duhet të dorëzojë certifikata ISO, sipas zërave të mallit qëdo të marrë përsipër të realizojë sipas aktit të marrëveshjes).

5. Operatorët Ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin certifikatat e produktit konform standarteve europiane për artikujt respektivë si më poshtë:

- Kolltuk *EN 12520:2016* ose ekuivalente SSH/EN
- *Karriqe zyre EN 1335-1:2020*, ose ekuivalente me SSH
- *Tavolinë zyre EN 527-1:2016+A1:2019* ose ekuivalente me SSH
- *Etazher me kapak për zyra EN 14073-2:2008* ose ekuivalente me SSH
- - Certifikatat kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, si dhe të jenë në shqip ose të shoqëruara me përkthim në shqip, të noterizuara në formën e kërkuar.

- Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikatat e kerkuara me lart ne perputhje me angazhimin ne Bashkimin e Operatoreve Ekonomike.

6. Ne rastet kur Operatori Ekonomik nuk eshte vete prodhues ai duhet te paraqese, "Autorizim Prodhuesi" dhe/ose "Kontratë Furnizimi"/"Kontrate Bashkëpunimi" nga një "Distributor i Autorizuar" në të cilat, duhet të jenë përcaktuar emërtimet e produkteve per te cilet bashkepunohet, si dhe te dhenat e kontraktuesit prodhues si: Adrese, telefon, fax, e-mail, website.

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e autorizuara nga AK.

8. Subjekti ofertues duhet të deklarojë garancinë e mallrave objekt prokurimi e cila duhet të jetë jo më pak se një vit, gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike.

9. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin mostra të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor. Lista e mostrave qe duhet te paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhëna në DST, janë:

- • Karrige rrotulluese me stof.
- • Tavoline pune dhe kompjuteri.
- • Tavoline pune dhe kompjuteri per dy persona.
- • Etazher me kanata xhami.

Mosparaqitja e mostrave në ditën dhe orën e hapjes së ofertave dhe mosparaqitja e mostrave jo ne perputhje me kerkesat e Autoritetit Kontraktor, është kusht skualifikues.

Afati i lëvrimit të mallërave do të jetë 30 ditë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**


Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><input type="checkbox"/> ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p></p> <p>_____</p> <p>_____</p>

<p>kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

